

VENDIM
Nr. 147, datë 29.3.2023

PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË GJYKATAVE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “d” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, në nenet 61, 89 dhe 97, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në ligjin nr. 98/2016, “Për pushtetin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të planifikimit strategjik, administrimit dhe buxhetit,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kategorive të gjykatave si më poshtë:

I. Kategoria e parë (e lartë):

- a) Gjykata e Lartë;
- b) Gjykata e Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- c) Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- d) Gjykata e Apelit Administrativ;
- e) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- f) Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- g) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë;

II. Kategoria e dytë (e mesme):

- a) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- b) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
- c) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
- d) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
- e) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
- f) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
- g) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
- h) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;
- i) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë;

III. Kategoria tretë (e ulët):

- a) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
- b) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;
- c) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
- d) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami